



Klinë:21.05.2019

## FTESË PUBLIKE

*Të nderuara Biznese, Individë dhe Organizata Joqeveritare të Republikës së Kosovës,*

**Komuna Klinë-Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (DBPZHR) ka kënaqësinë t'ju ftojë të merrni pjesë në edicionin e dytë radhazi në "Panairin e Produkteve Vendore" që do të mbahet nga data **06-07 dhe 08 Qershor, në Sheshin "Mujë Krasniqi" në Klinë.****

**"Panairi i Produkteve Vendore" Klina 2019**, është eveniment i cili do të organizohet për herë të dytë pas suksesit që kishte në edicionin e kaluar duke pasur parasysh që në tre ditët e panairit kishte vizitor të shumtë dhe shume biznese ekspozuan produktet e tyre, panairi edhe këtë vit do të mbahet për nder të Festivalit Folklorik **"I Këndojmë Lirisë"** që organizohet nën patronatin e Kryetarit të Komunës **z. Zenun Elezaj.**

Synimi është që ky panair në të ardhmen të jetë tradicional i dizajnuar si një mundësi për të mbështetur prodhuesit vendor me produktet e tyre, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme si dhe bizneset e reja me mundësin e promovimit të produkteve të tyre dhe në avancimin e nismave të tyre për komunikim dhe marketing, si dhe të lehtësojë takimet Biznes-Biznes.

Për tre ditë rresht, mbi 40 Biznese, Individë dhe OJQ vendore të shquara për prodhime vendore të cilësisë së lartë do të promovojnë produktet e tyre që variojnë nga industria e ushqimit deri tek artizanalet dhe punimet artistike.

Hapja solemne e panairit do të mbahet të **Enjte më 06 Qershor, nga ora 18:00**

Përparësi do të kenë produktet vendore.

Aplikimi është i hapur **23.05.2019** deri me **03.06.2019**. Aplikimet mund të behën edhe gjate vikendit përmes emailit: **panairikline@gmail.com**

**Drejtori i BPZHR**

**z.Naser Morina**



Aplikacionin munt ta shkarkoni në <https://kk.rks-gov.net/kline/category/konkurset-e-njoftimet/thirrje-per-propozime/>